



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 25  
04.08.2015

NR. VENDIMI 18  
05.08.2015

**V E N D I M**

**«Për Sekuestrim Pasurie»**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej

**GJYQTARE: Liljana BAKU**

Asistuar nga sekretar seance **Besjan Hysi**, sot në datë 05.08.2015, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, kërkesën penale Nr.25 Regj. me:

**KËRKUESE:**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Ened NAKUÇI**.

**KUNDËR:**

**Shtetasit D. GJ.**, i biri i L. dhe i I., i datëlindjes xxxx, me shtetësi shqiptare, lindur në xxxx, xxx dhe banues në fshatin xxxx, Komuna xxxx, xxxx.

**OBJEKTI:**

I.Sekuestrimi i pasurive të përshkruara më poshtë:

**1.** Pasuria me Nr.xxxx, ndodhur në volumin Nr.x, faqe xxx, zk.xxxx, me adresë Fshati xxxx, Komuna xxxx, i emërtuar “xxxx”, me sipërfaqe ndërtimore xxxx m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi xxxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe objektesh xxxx m<sup>2</sup>, i përbërë nga një objekt i formës x katësh, i emërtuar “xxxx”; një objekt i formës x katësh, i emërtuar “xxxx”; një objekt një katësh, i emërtuar “xxxx”; një pishinë; motel me dy dhoma; një objekt i emërtuar “xxxx; një objekt magazinë i formës x katësh.

**2** Pasuria me Nr.xxxx, vol.x fq.xx në zk.xxxx, pemishte + truall + ndërtesë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, e blerë në datë xxxx, në shumën xxx lekë, nga shtetasit L. e I. Gj. (nëna dhe babai i D.). Kjo sipërfaqe ka qenë e

regjistruar në emër të L. I. Gj., si tokë bujqësore, e fituar me Aktin e Vitit 1995 dhe si bashkëpronar në të rezulton edhe shtetasi D. Gj..

**3.** Pasuria me Nr.xxx vol.x fq.x në zk.xxxx, arë me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx.

**4.** Pasuria me Nr.xxxx vol.xx fq.xx zk.xxxx, arë me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx.

**5.** Pasuria me Nr.xxxx vol.x fq.xx zk.xx, tokë arë, e ndodhur në xxxx, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, e blerë në datë xxxx nga shtetasi Q. M., për shumën xxxx lekë.

**6.** Pasuria me Nr. xxx vol.x fq.xxx zk.xxxx, ndërtesë + truall, me sipërfaqe trualli xxxx m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë xxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, e blerë në datë xxxx, në shumën xxxx lekë, nga shoqëria “xxxx” Sh.A. (shoqëri karburanti), me qendër në xxxx, ku ndodhet e ngritur një godinë shërbimi me x kate + bodrum, sipërfaqe bodrumi xxx m<sup>2</sup>, sipërfaqe kati xxx m<sup>2</sup>, për të cilën është dhënë leje legalizimi.

**7.** Pasuria Nr.xxx vol.x, fq.xx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx.

**8.** Pasuria Nr.xxxx vol.xx, fq.xx zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, brenda të cilës ndodhet një ndërtim me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, dhe truall xxx m<sup>2</sup>.

**9.** Pasuria Nr.xxx, volumi x fq.xxx, ndodhur në zonën kadastrale Nr.xxxx, me adresë xxxx-xxxx, pasuri tokë arë, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me indeks të hartës xxx, fituar me Kontratën Nr.xxxx Rep. Kol.xxxx datë xxxx.

**10.** Pasuria Nr.xxx, volumi x, fq.xx, ndodhur në zonën kadastrale Nr.xxxx, me adresë xxxx-xxxx, tokë arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me indeks të hartës xxxx, fituar me Kontratën Nr.xxxx Rep. Kol.xxxx datë xxxx.

**11.** Shoqëria “xxxx“ Sh.P.K. me numër NIPTI xxxx, së bashku me të gjithë asetet e saj.

**II.** Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet Z.S. M., i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë

së Financave Tiranë.

**III.** Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit xxxx.

**BAZA LIGJORE:** -

            
Ligji Nr.10192 datë 03.12.2009 «Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë».

Në përfundim të gjykimit gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur, mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi dëgjoji pretendimin përfundimtar të prokurorit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

**V Ë R E N**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë xxxx, regjistroi procedimin pasuror Nr.xx, Viti xxxx, në ngarkim të shtetasit D. (D.) GJ., ndryshe I. D., i biri i L. dhe I., lindur më xxxx, në xxx, si person i dënuar nga organet gjyqësore kompetente, në Itali, me x vjet e x muaj burgim, për kryerjen e veprave penale të bashkëpunimit në organizatë kriminale, me qëllim favorizimin e emigracionit të paligjshëm dhe shfrytëzimin e prostitucionit, të parashikuara nga legjislacioni penal italian. Gjithashtu, shtetasi D. Gj. është nën hetim edhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx, për llogari të procedimit penal Nr.xxxx/ xxxx, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Procedimi pasuror është rrjedhojë e procedimit penal të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx (e cila përcolli në organin e prokurorisë së krimeve të rënda materialet referuese me Shkresën Nr.xxxx datë xxxx) dhe e referimit të bërë, në datë xxxx, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga përmbajtja e materiali referues rezultoi se D. Gj., me vendimin e formës së prerë, datë xxxx të Gjykatës së Apelit, Milano, Itali, u dënua me x vjet dhe x muaj burgim (vendimi la në fuqi, pjesërisht, vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në Milano, dhënë në datë xxxx).

Për shtetasin D. Gj., Prokuroria e Përgjithshme në Milano nxori urdhërin e ekzekutimit, Nr.xxxx, datë xxxx, për dënimin e mbetur prej x vjet dhe x muaj burgim, i mbetur i paekzekutuar për shkak të mungesës së të dënuarit, duke përfituar ulje në masën prej x vjet burg, nga amnistia e Vitit xxxx.

Nga aktet e dërguara nga autoriteti gjyqësor italian, rezultoi se shtetasi D. Gj. u dënua për faktet penale të mëposhtme:

-Për bashkëpunim me disa persona, në kryerjen e disa krimeve relative, me qëllim futjen, në mënyrë klandestine, në territorin e shtetit italian, të grave me origjinë nga vendet e Evropës Lindore, me qëllim shfrytëzimin për prostitucion duke qënë ai në rolin e organizatorit dhe drejtuesit të grupit, me shtrirje të veprimtarisë në Milano dhe Puglia, para Vitit 1999 dhe deri sot në vazhdimësi.

-Për organizim dhe drejtim, në bashkëpunim, të aktivitetit, të kryer në Puglia, para datës 8.1.2000, i cili favorizoi hyrjen klandestine, në Itali, të dy vajzave, me origjinë moldave, me qëllim shfrytëzimin për prostitucion.

-Për veprim, në bashkëpunim, me qëllim futjen, favorizimin dhe shfrytëzimin për prostitucion, të dy grave, kryer në Milano, para datë 8.1.2000.

-Për organizim dhe drejtim të aktivitetit, në bashkëpunim me disa persona, të kryer në Bari, ndërmjet datave 8 dhe 9 Janar 2000, me qëllim futjen, në mënyrë klandestine, në Itali, të tre vajzave, me origjinë moldave, për shfrytëzimin e tyre si prostituta.

-Për organizim dhe drejtim të aktivitetit, në bashkëpunim, të kryer në Milano, në periudhën nga Janari i Vitit 2000 deri në datë 6 Nëntor të Vitit 2000 (kohë kur pala e dëmtuar depozitoi kallëzimin) me qëllim favorizimin e hyrjes klandestine, në Itali, të tre vajzave, me origjinë moldave, për shfrytëzimin e tyre për prostitucion.

-Për organizim dhe drejtim të aktivitetit, në bashkëpunim, të kryer në Itali, në datë 15.12.2000, me qëllim favorizimin e hyrjes klandestine, në Itali, të katër vajzave, me origjinë të huaj (njëra rumune), për shfrytëzimin e tyre për prostitucion.

-Për veprimin, në bashkëpunim, në Milano, Itali, në datë 15.12.2000, me qëllim futjen, favorizimin dhe shfrytëzimin për prostitucion të katër grave.

-Për organizimin dhe drejtimin, në bashkëpunim me disa persona, të aktivitetit, që favorizonte hyrjen klandestine, në Itali, të vajzave me origjinë rumune, me qëllim prostituimit e tyre.

-Për favorizimin dhe shfrytëzimin, për prostitucion të V. A., kryer në Milano, në datë 13.1.2001 e në vazhdim.

Provat për fajësinë e D. Gj. u siguruan mbi bazën e një hetimi kompleks të kryer, duke përdorur metodës speciale të përgjimit telefonik dhe duke marrë dëshmitë e palëve të dëmtuara, të cilat denoncuan aktivitetin e kundraligjshëm të tij.

Mbi bazën e fakteve të përshkruara më sipër, meqënëse veprat penale “Trafikimi i femrave” dhe “Shfrytëzimi i prostitucionit”, kryer në rrethana rënduese, parashikoheshin edhe në Kodin Penal Shqiptar dhe, në bazë të nenit 3

pika 1 të Ligjit Nr.10192 date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ato përfshiheshin në fushën e zbatimit të tij, organi procedues, prokuroria, çmoi se pasuria e shtetasit D. Gj. duhej t’i nënshtrohej masave parandaluese të parashikuara në të.

Nevoja për vendosjen e masave parandaluese, mbi pasurinë e shtetasit D. Gj. dhe të personave të afërt me të, sipas parashikimeve në nenin 3 pika 2 gërma “a” të Ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009, ishte rrjedhojë edhe e hetimit të kryer nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, për llogari të procedimit penal Nr.xxxx, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal. Procedimi penal u regjistroi mbi bazën e materialeve të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut xxxx, ku referohej fakti i dënimit të shtetasit D. L. Gj. nga Gjykata e Milanos, në Itali dhe i nxjerrjes së një urdhër arresti, nga Gjykata e Monxas/Itali, me Nr.xxxx. datë xxxx, për kryerje të veprave penale “Dhunë seksuale”, “Akte të turpshme”, “Grabitje në rrethana rënduese” dhe “Mbajtje armësh zjarri”.

Në zbatim të vendimeve gjyqësore të sipërcituara, shtetasi D. Gj. u shpall në kërkim ndërkombëtar, nga Interpol Roma/Itali dhe, në datë xxxx, ai u arrestua për efekt ekstradimi, procedura e të cilit ende nuk ka përfunduar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, në kuadër të hetimeve paraprake, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, kreu verifikime në lidhje me identifikimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruara në emër të shtetasit D, Gj, dhe të personave të lidhur me të. Ky verifikim u bazua edhe në dyshime se shtetasi D, Gj, si drejtues i një organizate kriminale, me të ardhurat e siguruara nga aktiviteti kriminal, i kryer prej tij dhe prej bashkëpunorëve të tij, kishte blerë disa shtëpi në Shqipëri.

Në kuadër të hetimit paraprak u administruan edhe materialet e mbërritura në ekzekutim të letërporosisë, me Shkresën Nr.xxxx Prot. datë xxxx, nga të cilat rezultoi se shtetasi D. Gj. njihej në Itali edhe me emrin I. D., referuar pasaportës, së paraqitur prej tij, në momentin e ndalimit nga policia italiane. Në Itali ai u identifikua në një rast si autor i grabitjes me dhunë të shumës prej xxxx lireta dhe si i përfshirë në veprimtarinë kriminale. Për veprimtarinë kriminale në fushën e shfrytëzimit për prostitucion, rezultoi dënimi i tij dhe nxjerrja e urdhërit për ekzekutimin e dënimit me x vjet dhe x muaj burgim dhe xxxx Euro gjobë.

Nga verifikimet e kryera në institucionet përkatëse në shtetin italian, rezultoi se shtetasi D. Gj. dhe familjarët e tij nuk kishin paraqitur deklarata të të ardhurave dhe nuk rezultonin, bashkëlidhur, të dhëna të tipit pasuror apo kontraktor. Gjithashtu, për ta nuk rezultonin llogari rrjedhëse, transaksione të pasurive të patundshme, të tanishme apo të hershme si dhe automjete të regjistruar në emër të tyre.

Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, rezultoi se shtetasi D. Gj. kishte pasuri, në vlera të konsiderueshme, në emër të tij dhe për to u dyshua se ishin produkte të veprimtarisë kriminale të kryer në Itali (për të cilën dhe është dënuar) si një veprimtari e kryer për qëllime përfitimi materiale dhe, konkretisht:

Sipas Shkresës Nr.xxxx Prot, datë xxxx, të Zyrës së ALUZNIT, rezultoi se shtetasi D. L. Gj. kishte aplikuar për legalizim të ndërtimeve informale, të ndodhura në fshatin xxxx, duke dorëzuar, pranë Komunës xxxx, formularët e vetëdeklarimit me të dhënat përkatëse për një banesë x katëshe, me sipërfaqe ndërtimi xxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli të zënë xxxx m<sup>2</sup>, me pronësi të pretenduar të truallit dhe vit ndërtimi xxxx; për një banesë x kate, me sipërfaqe ndërtimi xxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli të zënë xxxx m<sup>2</sup>, me pronësi të pretenduar të truallit dhe vit ndërtimi xxxx; për një banesë x katëshe, me sipërfaqe ndërtimi xxxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli të zënë xxxx m<sup>2</sup>, me pronësi të pretenduar të truallit dhe vit ndërtimi xxxx; për një banesë x katëshe, me sipërfaqe ndërtimi xxxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli të zënë xxx m<sup>2</sup>, me pronësi të pretenduar të truallit dhe vit ndërtimi xxxx; për një banesë një katëshe, me sipërfaqe ndërtimi xxxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli të zënë xxxx m<sup>2</sup>, me pronësi të pretenduar të truallit dhe vit ndërtimi xxxx; për një banesë x katëshe, me sipërfaqe ndërtimi xxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli të zënë xxxx m<sup>2</sup>, me pronësi të pretenduar të truallit dhe vit ndërtimi xxxx; për një banesë x katëshe, me sipërfaqe ndërtimi xxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli të zënë xxxx m<sup>2</sup>, me pronësi të pretenduar të truallit dhe vit ndërtimi xxxx; për një banesë x katëshe, me sipërfaqe ndërtimi xxxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli të zënë xxxx m<sup>2</sup>, me pronësi të pretenduar të truallit dhe vit ndërtimi xxxx;

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, me Shkresën Nr.xxxx Prot datë xxxx, dërgoi, bashkëngjitur, një kopje të njehsuar me origjinalin, të lejes së legalizimit, të dhënë në datë xxxx, për vetëdeklarimin e shtetasit D. L. Gj., në lidhje me objektin “xxxx”, me adresë Komuna xxxx. Sipas lejes së legalizimit rezultoi se ishte legalizuar një sipërfaqe prej xxxx m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi xxxx m<sup>2</sup>, sipërfaqja prej xxxx m<sup>2</sup> ishte sipërfaqe për

ushtrim aktiviteti, ndërtimi ishte mbi tokë, i ndarë në x kate, me emërtim, sipas vetëdeklarimit datë xxxx, “Supermarket, Bar-Restorant, Motel”; ndërtim x kate, me emërtim, sipas vetëdeklarimit të datës xxxx, “xxxxx”; ndërtim x katësh, me emërtim “xxxx”, sipas vetëdeklarimit të datës xxxx; “xxxx”, sipas vetëdeklarimit të datës xxxx; Qendër sportive (Motel 2 dhoma), sipas vetëdeklarimit të datës xxxx; Qendra Sportive Kalçeto, sipas vetëdeklarimit të datës xxxx; magazinë x katësh, sipas vetëdeklarimit të datës xxxx. Të gjitha objektet rezultojnë të ndërtuara mbi sipërfaqen e tokës në pronësi të shtetasit D. L. Gj., që ndodhej e regjistruar në zonën kadastrale me Nr. xxxx dhe numër pasurie xxxx, në fshatin xxxx, Komuna xxxx.

Sipas dokumentacionit, të ndodhur në dosjen e legalizimit në fjalë, vlera e investimit ishte përlllogaritur në shumën **xxxx lekë**. Pas legalizimit, pasuria rezultoi e regjistruar, në emër të shtetasit D. Gj., me Nr. Pasurie xxxx, në volumn nr.x, faqe xxx, zk.xxxx, me adresë Fshati xxxx, Komuna xxxx.

Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxxx, me shkresën Nr.xxxx Prot. datë xxxx, informoi se shtetasi D. Gj. kishte të regjistruar, në ZVRPP xxxx, pasurinë me Nr.xxxx vol.x fq.xx në zkxxx, pëmishte + truall + ndërtesë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, e blerë në datë xxxx, në shumën xxxx lekë, nga shtetasi L. e I. Gj. (nëna dhe babai i D.). Kjo sipërfaqe kishte qënë e regjistruar në emër të L. I. Gj. si tokë bujqësore e fituar me aktin e vitit 1995 dhe si bashkëpronar në të rezultonte edhe shtetasi D. Gj.; pasurinë me Nr.xxxx vol.xx fq.xx në zk.xxx, arë me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx; pasurinë me Nr. xxxx vol.xx fq.xx zk.xxxx, arë me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx; pasurinë me Nr.xxxx vol.x fq.xxx zk.xxxx, arë + truall, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, brenda të cilës kishte një ndërtim me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me datë regjistrimi xxxx (për këtë sipërfaqe, në kartelë, përshkruhet se ndodhet një kompleks shërbimesh supermarket, magazinë, disko, palestër, dhomë zhveshje, kalçeto, pishinë dhe **kjo është pasuria për të cilën është dhënë leja e legalizimit të sipërpërmendur**); pasuria me Nr.xxxx vol.x fq.xxx zk.xxxx, tokë arë, e ndodhur në xxxx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e blerë në datë xxxx nga shtetasi Q. M., për shumën xxxx lekë; pasurinë me Nr.xxxx vol.x fq.xxx zk.xxxx, ndërtesë + truall, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup> truall e ndërtesë xxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, e blerë në datë xxxx, në shumën xxxx lekë, nga shoqëria “xxxx“ Sh.A. (shoqëri karburanti), me qendër në xxxxx, ku ndodhej e ngritur një godinë shërbimi x katëshe dhe podrum, sipërfaqe bodrumi xxx m<sup>2</sup>, sipërfaqe kati xxx m<sup>2</sup>, për të

cilën ishte dhënë leje legalizimi.

Në kuadër të hetimit, organi procedues administroi edhe dokumentacionin përkatës të përbërë nga kartela dhe harta të pasurive përkatëse, të dërguara me Shkresat Nr.xxxx Prot datë xxxx dhe Nr.xxxx Prot datë xxxx.

Policia gjyqësore, me procesverbalin përkatës, datë xxxx, kqyri dhe mori kopje të akteve të pronësisë për: Pasurinë Nr.xxxx vol.x, fq.xx, zona kadastrale xxxx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur ne xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx; Pasurinë Nr.xxxx vol.xx, fq.xx zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur ne xxxx, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, brenda të cilës ndodhej një ndërtim xxx m<sup>2</sup>, dhe truall xxx m<sup>2</sup>; Pasurinë Nr.xxx, volumi x, fq.xxx, ndodhur në zonën kadastrale Nr.xxxx, me adresë xxxx, pasuri tokë arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me indeks të hartes xxxx, fituar me Kontratën Nr.xxxx Rep. Kol.xxxx, datë xxxx; Pasurinë Nr.xxx, volume x, fq.xx, ndodhur në zonën kadastrale Nr.xxxx, me adresë xxxx, lloji i pasurisë tokë arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me indeks të hartës xxxx fituar me Kontratën Nr.xxxx Rep. Kol.xxxx, datë xxxx.

Qendra Kombëtare e Rregjistrimit xxxx, me Shkresën Nr.xxxx Prot datë xxxx informoi se shtetasi D. L. Gj. ishte administrator në shoqërinë “xxxx» Sh.P.K. me NIPT xxxx, e regjistruar në datë xxxx (fillimisht administrator dhe ortak ishte regjistruar A. Gj. dhe, në Vitin 2006, me vdekjen e tij, kapitali themeltar ishte ndarë midis bashkëshortes dhe fëmijëve të tij dhe si administrator ishte caktuar vëllai, D. L. Gj.). Objekti i shoqërisë ishte tregëtimi me shumicë dhe pakicë, importi, eksporti i artikujve të llojeve të ndryshëm, transporti i mallrave, pikë servisi, tregëtimi i karburanteve me pakicë, vajrave lubrifikante dhe të gjithë nënprodukteve të tyre; D. L. Gj. ishte administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “xxxx » Sh.P.K. e regjistruar që në datë xxxx, objekti i të cilës ishte Import–eksporti me shumicë e pakicë i mallrave industriale, kinkaleri, ushqimore, hidrosanitare, druri, elektroshtëpiake, veshëmbathje, ilaçe, lëndë të para për industrinë, pjesë këmbimi, kancelari, pajisje shtëpiake; D. L. Gj. ishte administrator në shoqërinë “xxxx” Sh.P.K. me numër NIPT xxxx (për këtë subject, për shkak të mosplotësimit të të dhënave, nuk mund të thuhet nëse ishte i njëjti me atë të regjistruar në datë xxxx); Shtetasit A. L. Gj. dhe D. L. Gj. figuronin ortakë dhe administratorë në Shoqërinë “xxxx” Sh.P.K, regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, Nr.xxxx datë xxxx, me objekt të shoqërisë Import–eksport me shumicë e pakicë të mallrave industriale, kinkaleri, ushqimore, hidrosanitare, druri, elektroshtëpiake, veshmbathje, ilaçe, lëndë të para për industrinë, pjesë këmbimi, kancelari,



pajisje shtëpiake; Shtetasi A. L. Gj. figuronte administrator në Shoqërinë “xxxx” Sh.P.K, me numër NIPTI xxxx dhe “xxxx” Sh.P.K, me NIPT xxxx (për këto subjekte, për shkak të mosplotësimit të të dhënave, nuk mund të thuhej nëse ishte i njëjti me atë të rregjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, Nr.xxxx datë xxxx). Sipas Shkresës Nr.xxxx Prot datë xxxx, të Drejtorisë së Tatimeve xxxx, rezultoi se shoqëria e parë ishte regjistruar në datë xxxx dhe çregjistruar në datë xxxx, ndërsa e dyta ishte regjistruar në datë xxxx dhe kaluar në pasiv në datë xxxx. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj shkrese, informohej se për të dy subjektet në fjalë nuk kishte të dhëna dhe deklarime për bilance dhe pasqyra financiare.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me Shkresën Nr.xxxx Prot, datë xxxx, informoi se për subjektet e regjistruar kishte të dhënat: NIPT xxxx, me administrator D. Gj.; NIPT xxxx, me administrator A. Gj., NIPT xxxx, me administrator A. Gj..

Nga pasqyrat financiare të marra për këto shoqëri, rezultoi se nga Viti 2003 deri në Vitin 2006, fitimet neto, për Shoqërinë “xxxx” Sh.P.K. ishin përlllogaritur në shumën xxxx lekë dhe nga Viti 2006 deri në Vitin 2012 në shumën xxxx lekë; në total në shumën xxxx lekë. Fitimet neto nga Viti 2009 deri në Vitin 2012, për Shoqërinë “xxxx” Sh.P.K. ishin përlllogaritur në shumën xxxx lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me Shkresën Nr.xxxx Prot datë xxxx, informoi se shtetasit D. L. Gj. dhe I. L. Gj. nuk kishin deklaruar para cash, çeqe apo metale e sende të çmuara në pikat e kalimit kufitar doganor, për periudhën nga Mars 2004 deri në 15 Tetor 2012.

Në kuadër të hetimit u siguroa informacion edhe nga bankat e nivelit të dytë. Konkretisht, Banka xxxx me Shkresën datë xxxx, informoi se shtetasi D. L. Gj. ishte klient pranë kesaj banke dhe dispononte kredi me pakicë, në datë xxxx, në shumën xxxx lekë; në datë xxxx, kredi e tërhequr në shumën xxxx lekë, e përdorur për shlyerje kredie për A. Gj.; Pagesa të ndryshme në vazhdimësi ku përfshiheshin pagesa për këste kredie dhe gjendja aktuale ishte 0.00.

Banka xxxx informoi se subjektit “xxxx” Sh.P.K, me administratror A. Gj., i ishte dhënë kredi, nga ish Banka xxxx, në datë xxxx, në shumën xxxx Euro, për qëllime biznesi, për t’i përdorur për aktivitetin tregëtar të importit të mallrave, për një afat prej 90 ditësh. Në

datë xxxx, ish Banka xxxx kishte lidhur marrëveshje, për ndryshim kontrate, me subjektin “xxxx” Sh.P.K, me administrator A.Gj., në bazë të të cilës, sipas kërkesës së shoqërisë, asaj i ishte dhënë një rritje e linjës së kredisë në xxxx euro. Në datë xxxx, Banka xxxx i dha Shoqërisë “xxxx” Sh.P,K, me administratort D.Gj., shumën e kredisë prej xxxx Euro, për financimin e pjesshëm të kostos së investimit për kompleksin e tregëtisë dhe shërbimeve xxxx xxxx. Nga shuma e marrë kredi rezultoi e likujduar, deri në Shtator të Vitit 2012, shuma prej xxxx Euro, ndërsa shuma e papaguar ishte xxxx Euro. Në datë xxxx, Banka xxxx i dha Shoqërisë “xxxx” Sh.P.K, me administrator D.Gj., shumën e kredisë prej xxxx Euro, për mbylljen e linjës së kredisë me afat, pra të overdraftit të dhënë në Vitin 2003 nga ish Banka xxxx. Prej saj, deri në Shtator të Vitit 2012, ishte likujduar shuma prej xxxx Euro dhe shuma e palikujduar, ishte e barabartë me xxxx Euro.

Në përmbledhje të marëdhënieve të huasë me bankën italiane, rezultoi se subjektit “xxxx” Sh.P.K ju akordua, nga ish Banka xxxx, linjë kredie me afat, në formë overdrafti, në shumën xxxx Euro, për qëllim biznesi, shumë e cila ndodhej në llogarinë bankare të subjektit, prane ish Bankës xxxx dhe nuk u mor cash, duke u përdorur për aktivitet tregëtar. Likuidimi i shumës së kredisë me afat, si overdraft i bankës, në shumën xxxx Euro u bë nga depozita e lënë peng nga A.Gj., ndërsa i shumës tjetër prej xxxx Euro, me anë të kredisë bankare, të dhënë në datë xxxx, nga Shoqëria e përfaqësuar nga D.Gj.. Kredia bankare rezultoi e mbyllur, nga ana e Shoqërisë “xxxx” Sh.P.K në muajin Shtator të Vitit 2012, kohë kur u regjistrua procedimi penal në ngarkim të D. Gj.. Në lidhje me burimin e të ardhurave që shërbyen për të likujduar shumat e kredive të marra, u mor informacioni se subjekti ju referua aktivitetit tregëtar të kryer, nga subjekti “xxxx” Sh.P.K, nga Viti 2003 deri në Vitin 2012 dhe nga subjekti “xxxx” Sh,P.K, nga Viti 2009 deri në Vitin 2012. Në bazë të pasqyrave financiare të këtyre shoqërive, rezultoi se aktiviteti i tyre, ndër vite, siguroi një fitim neto në shumën xxxx lekë, konkretisht: Per linjën e kredisë së parë, dhënë në formë overdrafti, në shumën xxxx euro, likujdimi i kësaj shume u bë me depozitën e lënë peng, në shumën xxxx Euro nga A.Gj. në bankë, ndërsa diferenca, në shumën xxxx euro u pagua me kestin e kredisë të marrë në muajin Prill të Vitit 2011 nga D.Gj.. Për linjën e kredisë, të dhënë në datë xxxx, për investim dhe për linjën e kredisë, datë xxxx, si burim i likujdimit shërbyen të ardhurat nga D.Gj., të cilat nuk gjeneruan nga aktiviteti i tatueshëm i shoqërise, pasi nga Viti 2010 deri në Vitin 2011, aktiviteti i subjektit të tregëtisë ishte me fitim neto në total me xxxx lekë, e pamjaftueshme për të likujduar këstet e kredive për periudhën nga Viti 2010 deri në Vitin 2012, të cilat rezultonin në shumën xxxx euro ose xxxx

lekë.

Verifikimi i pasurive dhe i të ardhurave u krye në Shqipëri dhe në Itali. Në përgjigje të letërporosisë drejtuar autoritetit gjyqësor italian, përcjellë në organin procedues me Shkresën Nr.xxxx Prot datë xxxx të Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se nuk kishte konfirmime të profilit financiar me inisiativë të shtetasit D. Gj. apo familjarëve të tij apo të deleguara autoriteteve gjyqësore.

Nga të dhënat e marra nga ALUIZNI, vlera e investimit të kompleksit “xxxx” rezultoi e barabartë me xxxx lekë, ndërsa objektet që përfaqësonin atë, ishin ndërtime para Vitit 2006. Nisur nga niveli i të ardhurave të llogaritura në shumën xxxx lekë, dukshëm ato nuk mund të justifikonin ndërtimin e këtij kompleksi.

Shtetasi D. Gj., i dënuar për kryerje të veprave penale “Pjesëmarrja në organizata kriminale” dhe “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”, të parashikuara edhe nga Kodit Penal Shqiptar, duke qënë njëkohësisht person në hetim për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, rezulton subjekt i hetimit pasuror, së bashku me familjarët e tij, sipas nenit 3 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,

Në kuadër të hetimit të kryer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx, me Vendimin Nr.xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, u vendos masa e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për pasurinë me Nr.xxxx, ndodhur në volumnin Nr.x, faqe xxx, zk.xxxx, me adresë Fshati xxxx, Komuna xxxx, “Kompleks Shërbimesh xxxx”, duke u specifikuar edhe sipërfaqet dhe objektet pjesë përbërëse të tij. Aktualisht masa e sekuestros preventive rezulton e hequr po me vendim gjykate.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, mbi bazën e vlerësimit të informacioneve të marra dhe trajtuara hollësisht sa më sipër, çmoi se një pjesë e madhe e pasurisë së shtetasit D. Gj. dhe familjarëve të tij, nuk ishin objekt i ligjit parandalues për shkak se ishin fituar para kryerjes së veprimtarisë kriminale nga i dyshuari. Ndërsa pasuria e cila nuk justifikohet nga pikëpamja financiare dhe përkonte me periudhën pas përfshirjes së të dyshuarit D. Gj. në veprimtarinë kriminale të pjesëmarrjes në organizata kriminale dhe të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, përfaqësohej nga: 1. Pasuria me Nr.xxxx, ndodhur në volumnin Nr.x, faqe xxx, zk.xxxx, me adresë Fshati xxxx, Komuna xxxx, i emërtuar “xxxx”, me sipërfaqe ndërtimore xxxx m2, sipërfaqe ndërtimi xxxx m2, me sipërfaqe xxxx m2, i përbërë nga një objekt i formës x

katësh, i emërtuar “xxxx”; një objekt i formës x katësh, i emërtuar “xxxx”; një objekt x katësh, i emërtuar “xxxx”; një pishinë; motel me dy dhoma; një objekt i emërtuar

“xxxx; një objekt magazinë i formës x katësh. 2. Pasuria

me Nr.xxxx, vol.x fq.xx në zk xxxx, pemishte + truall + ndërtesë, me sipërfaqe xxxx m2, e ndodhur në xxxx, xxxx, e blerë në datë xxxx, në shumën xxxx lekë, nga shtetasit L. e I. Gj. (nëna dhe babai i D.). Kjo sipërfaqe ka qenë e regjistruar në emër të L. I. Gj., si tokë bujqësore, e fituar me Aktin e Vitit 1995 dhe si bashkëpronar në të rezulton edhe shtetasi D. Gj.. 3. Pasuria me Nr.xxxx vol.xx fq.xx në zk.xxxx, arë me sipërfaqe xxxx m2, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx. 4. Pasuria me Nr.xxxx vol.xx fq.xx zk.xxxx, arë me sipërfaqe xxxx m2, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx. 5. Pasuria me Nr.xxxx vol.x fq.xxxx zk.xxxx, tokë arë, e ndodhur në xxxx, me sipërfaqe xxxx m2, e blerë në datë xxxx nga shtetasi xxxx, për shumën xxxx lekë. 6. Pasuria me Nr. xxxx vol.x fq.xxx zk.xxx, ndërtesë + truall, me sipërfaqe trualli xxxx m2 dhe sipërfaqe ndërtesë xxx m2, e ndodhur në xxxx, xxxx, e blerë në datë xxxx, në shumën xxxx lekë, nga shoqëria “xxxx” Sh.A. (xxxx), me qendër në xxxx, ku ndodhet e ngritur një godinë shërbimi me x katë + bodrum, sipërfaqe bodrumi xxx m2, sipërfaqe kati xxx m2, për të cilën është dhënë leje legalizimi. 7. Pasuria Nr.xxxx vol.x, fq.xx, zona kadastrale xxxx, me sipërfaqe xxxx m2, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx. 8. Pasuria Nr.xxxx vol.xx, fq.xx zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, me sipërfaqe xxx m2, brenda të cilës ndodhet një ndërtim me sipërfaqe xxx m2, dhe truall xxx m2. 9. Pasuria Nr.xxx, volumi x, fq.xxx, ndodhur në zonën kadastrale Nr.xxxx, me adresë xxxx, pasuri tokë arë, me sipërfaqe xxxx m2, me indeks të hartës xxxx), fituar me Kontratën Nr.xxxx Rep. Kol.xxxx datë xxxx. 10. Pasuria Nr.xxxx, volumi x, fq.xxx, ndodhur në zonën kadastrale Nr.xxxx, me adresë xxxx, tokë arë, me sipërfaqe xxxx m2, me indeks të hartës xxxx, fituar me Kontratën Nr.xxxx Rep. Kol.xxxx datë xxxx. 11. Shoqëria “xxxx“ Sh.P.K. me numër NIPTI xxxx, së bashku me të gjithë asetet e saj.

Sipas prokurorisë, për pasuritë e përshkruara më sipër, duhej të vendosej masa e sekuestrimit sepse plotësoheshin kriteret e parashikuara nga neni 11 i Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar

dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi së pari ato ishin përfituar pas përfshirjes së personit të hetuar D. Gj. në veprimtari kriminale; Së dyti, këto pasuri nuk i përgjigjeshin nivelit të të ardhurave të të dyshuarit dhe familjarëve të tij; Së treti, ekzistonte rreziku i humbjes apo tjetërsimit pasi ndaj vendimit të sekuestrimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, mund të ankoheshin të interesuarit, duke kërkuar revokimin e saj si dhe refuzimin e kërkesës për konfiskim.

Në datë xxxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë paraqiti para kësaj Gjykate, kërkesën me objekt sekuestrimin e pasurive të përshkuara më sipër, duke patur si bazë ligjore Ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të Ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesëditor, të parashikuar në këtë dispozitë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e paraqitur.

Në kërkesë dhe në seancë gjyqësore prokurori i qëndroi pretendimeve në lidhje me dyshimet që rëndonin mbi shtetasin D. Gj.; për qënien e tij dhe të familjarëve të tij subjekte të ligjit parandalues; për mungesën e justifikimit të pasurive me nivelin e të ardhurave dhe, për ekzistencën e rrezikut të tjetërsimit apo humbjes së tyre.

Në funksion të provueshmërisë së pretendimeve dhe kërkesës në gjykim, prokurori paraqiti si provë aktet që kishin të bënin me dënimin e shtetasit D. Gj., nga Gjykata e Milanos Itali, për veprat penale të pjesmarrjes në organizatë kriminale dhe të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese; aktet në lidhje me regjistrimin e procedimit penal, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, përfshirë edhe vendimin e gjykatës, pranë kësaj prokurorie, për vendosjen e sekuestros preventive; dokumentet bankare ku dokumentoheshin marrëdhëniet e huasë së shtetasit nën hetim apo vëllait të tij me bankat, në lidhje me kreditë e marra dhe shkallën e likuidimit të tyre; të dhënat e marra nga bankat e nivelit të dytë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme në rrethe, në lidhje me depozita apo pasuri të paluajtëshme në emër të shtetasit D. Gj. dhe familjarëve të tij; informacionet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe Doganave për aktivitetin tregëtar dhe për mungesën e deklarimeve për para cash në pikat e kalimit kufitar.

Gjykata në analizë të pretendimeve të prokurorit dhe provave të paraqitura prej tij, çmon se kërkesa është e drejtë, e bazuar ligj dhe prova dhe, si e tillë, duhet të pranohet për këto arsye:

**I. Kërkesa u paraqit në zbatim të nenit 3 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për**

parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të titulluar “Fusha e zbatimit”.

**Në pikën 1 gërmat “a” dhe “d” të Ligjit parashikohet zbatimi i tij për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje, për kryerjen prej tyre të veprave penale “Pjesmarrja në organizata kriminale” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në pikën 2 gërma “a” parashikohet zbatimi i ligjit edhe mbi pasuritë e personave të afërm të të dyshuarve për kryerje të veprave penale të parashikuara në pikën 1, ndërsa në gërmën “b”, ndërmjet të tjerave, edhe mbi pasuritë e personave fizikë që në një formë apo në një tjetër kanë ndikuar në veprimtarinë e jashtëligjshme të personave të parashikuar në pikën 1.**

U provua në gjykim se shtetasi D. Gj. është shtetas i dënuar nga gjykata italiane për veprën penale të pjesmarrjes në organizata kriminale dhe të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, ndërkohë që është nën hetim për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, për të cilën është duke proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, për pasojë ai dhe të afërmit e tij janë subjekte e zbatimit të Ligjit dhe, pasuria e tyre i nënshtrohet masave të parashikuara në të.

**II.** Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të Ligjit, gjykata çmon se për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë është e domosdoshme ekzistenca njëkohësisht e dy kriterëve të përgjithshme që kanë të bëjnë me: **1.** Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje që tregojnë se personat mund të jenë të përfshirë në veprimtari kriminale. **2.** Zotërimin e pasurive dhe të ardhurave që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe; Ekzistenca e të paktën njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Për shtetasin D. Gj., kushti i përgjithshëm është i pranishëm dhe njëkohësisht i tejkaluar në nivelin e tij pasi nuk kemi më dyshim të bazuar në indicje por kemi një vendim gjyqësor të formës së prerë, dhënë nga autoriteti gjyqësor italian, në të cilin ai rezulton i dënuar, për vepra penale të përfshira në rrethin e veprave që hyjnë në fushën e zbatimit të ligjit. Gjithashtu, shtetasi D. Gj. rezulton nën hetim edhe për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, e përfshirë, edhe kjo, në rrethin e veprave të fushës së zbatimit të ligjit.

Shtetasi D. Gj. dhe familjarët e tij nuk kanë të regjistruar aktivitet tregtar apo të ardhura të tjera të ligjshme, që të mund të justifikojnë pasuritë objekt sekuestrimi (kriteri 2 i përgjithshëm).

Ekziston rreziku real për tjetërsimin e pasurive. Duke qënë se masa e sekuestros preventive, e vendosur me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, është e kushtëzuar nga ecuria e procedimit penal, në rast pushimi të procedimit, është e natyrshme që shtetasi D. Gj. dhe familjarët e tij të bëjnë të gjitha përpjekjet për tjetërsim, me qëllim shmangien nga një konfiskim i mundshëm (kriteri i veçantë i parashikuar në gërmën “a” të pikës 1 të nenit 11). Ky rrezik bëhet edhe më evident pasi shtetasi nën hetim D. Gj. të njoftohet edhe për procedimin pasuror të nisur ndaj tij dhe, për masën e sekuestros të vendosur nga kjo gjykatë.

Ndodhur para faktit të heqjes së masës së sekuestros preventive, referuar nenit 5 pika 3 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009, gjykata nuk mund të urdhërojë pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestros parandaluese.

Në bazë të pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi gjykata vlerësoi praninë e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për vendosjen e masës së sekuestros, çmon se ekziston detyrimi që të njoftojë zotëruesin e pasurive të sekuestruara për vendimin e marrë prej saj. Për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën e paraqitur të drejtë dhe ligjore, vendimi i saj duhet t’i njoftohet shtetasit nën hetim D. Gj. dhe prindërve të tij.

Në bazë të pikës 3 të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të Ligjit në fjalë, kompetente për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të pasurive janë përmbaruesit gjyqësorë dhe, për administrimin e tyre administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Në këto kushte, është detyrim ligjor për gjykatën që në vendimin e saj të urdhërojë zyrën e përmbarimit, në juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e luajtshme (neni 516 i Kodit të Procedurës Civile) dhe, një administrator të agjensisë, të cilët do të koordinojnë punën për zbatimin e vendimit të sekuestros.

## **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d”, nenit 5 pika 3, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma “a”, nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

## **V E N D O S**

Pranimin e kërkesës, vendosjen nën masën e sekuestros të pasurive të poshtëshënuara:

1. Pasuria me Nr.xxxx, ndodhur në volumin Nr.x, faqe xxx, zk.xxxx, me

adresë Fshati xxxx, Komuna xxxx, i emërtuar “xxxx”, me sipërfaqe ndërtimore xxxx m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi xxxx m<sup>2</sup>, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, i përbërë nga një objekt i formës x katësh, i emërtuar “xxxx”; një objekt i formës dy katësh, i emërtuar “xxxx”; një objekt x katësh, i emërtuar “xxxx”; një pishinë; motel me x dhoma; një objekt i emërtuar “xxxx

; një objekt magazinë i formës x katësh.

**2.** Pasuria me Nr.xxxx, vol.x fq.xx në zk. xxxx, pemishte + truall + ndërtesë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, e blerë në datë xxxx, në shumën xxxx lekë, nga shtetasit L. e I. Gj. (nëna dhe babai i D.).

**3.** Pasuria me Nr.xxxx vol.xx fq.xxx në zk.xxxx, arë me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, xxxx, me datë regjistrimi xxxx.

**4.** Pasuria me Nr.xxxx vol.xxx fq.xx zk.xxxx, arë me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, me datë regjistrimi xxxx.

**5.** Pasuria me Nr.xxxx vol.x fq.xxx zk.xxxx, tokë arë, e ndodhur në xxxx, xxxx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e blerë në datë xxxx nga shtetasi Q. M., për shumën xxxx lekë.

**6.** Pasuria me Nr. xxxx vol.x fq.xxxx zk.xxxx, ndërtesë + truall, me sipërfaqe trualli xxxx m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë xxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, e blerë në datë xxxx, në shumën xxxx lekë, nga shoqëria “xxxx” Sh.A. (shoqëri xxxx), me qendër në xxxx, ku ndodhet e ngritur një godinë shërbimi me x katë + bodrum, sipërfaqe bodrumi xxx m<sup>2</sup>, sipërfaqe kati xxxx m<sup>2</sup>, për të cilën është dhënë leje legalizimi.

**7.** Pasuria Nr.xxxx vol.x, fq.xx, zona kadastrale xxxx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, e ndodhur në xxxx, me datë regjistrimi xxxx.

**8.** Pasuria Nr.xxxx vol.xx, fq.xx zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, brenda të cilës ndodhet një ndërtim me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, dhe truall xxxx m<sup>2</sup>.

**9.** Pasuria Nr.xxxx, volumi x, fq.xxx, ndodhur në zonën kadastrale Nr.xxxx, me adresë xxxxx, pasuri tokë arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me indeks të hartës xxxx, fituar me Kontratën Nr.xxxx Rep. Kol.xxxx datë xxxx.

**10.** Pasuria Nr.xxx, volumi x, fq.xxx, ndodhur në zonën kadastrale Nr.xxxx, me adresë xxxx, tokë arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me indeks të hartës xxxx, fituar me Kontratën Nr.xxxx Rep. Kol.xxxx datë xxxx.

**11.** Shoqëria “xxxx“ Sh.P.K. me numër NIPTI xxxx, së bashku me të gjithë asetet e saj.



Për ekzekutimin e vendimit të sekuestros ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxxx dhe, për administrimin e pasurisë së sekuestruar, Z.S. M., administrator në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Urdhërohet K/Sekretaria, pranë kësaj Gjykate, t'u njoftojë shtetasve D. Gj., L. Gj. dhe I. Gj. vendimin e sekuestrimit.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

**U shpall sot në Tiranë, në datë 05.08.2015.**

**SEKRETAR**

**Besjan HYSI**

**GJYQTARE**

**Liljana BAKU**







